

**17 shtator 2009  
14:00**

**Intervistë për Radio Dukagjinin  
Sadri Ferati, ministër i MAPL-së**

**Pyetje:**

**Në përputhje me ligjin për kufijtë administrativë zgjedhjet do të mbahen në 36 komuna. Mitrovica dhe Parteshi nuk përfshihen tash për tash, lihen pas themelimit të ekipeve përgatitore.**

**A nevojiten këto përgatitje të veçanta apo kjo ndërlidhet me rrethanat politike, ndoshta duhet pritur që serbët të tregojnë interesim për planin Ahtisari?**

**Përgjigje:**

Pikërisht sipas ligjit për kufijtë administrativ komunal, ligjit që derivon nga Pakoja e Ahtisarit, Kosova definohet që në 38 komuna të mbahen zgjedhjet lokale, ndërsa në Mitrovicën e Veriut dhe Partesh duhet të presim të angazhohemi që t'i krijojmë kushte më të volitshme për t'i mbajtur zgjedhjet edhe atje dhe ajo lidhet me shumë faktorë, sidomos Mitrovica lidhet edhe me një përgatitje më të mirë në aspektin administrativ, në aspektin e listave zgjedhore, ngase qytetarët kanë pasë edhe deri tash shumë probleme që të evidentohen saktësisht cili është banor i pjesës veriore, duke e ditë se qytetarët nuk kanë mundësi që të jetojnë nëpër pronat po njëkohësisht kemi edhe krijimin e një ambienti i cili do të kishte mundur edhe me mundësi realizimin e të drejtave minimale po edhe vet pjesëmarrjen e qytetarëve në ndërtimin e këtyre institucioneve dhe që pastaj të mund të marrin shërbime nga këto institucione, ngjajshëm është edhe me situatën në Partesh, ku deri tash nuk është tregu një vullnet i fuqishëm nga vet qytetarët, dhe liderët lokal që të bashkëpunojnë në mënyrë që këto përgatitje të jenë më të fuqishme që me rastin e organizimit të zgjedhjeve atje të vijë në shprehje vullneti i qytetarëve dhe të bëhet i mundur instalimi i strukturave komunale, por këto dy njësi nuk do të vonohen shumë, ne do t'ju ndihmojmë që në një të ardhme të afert t'u ndihmojmë të mbahen zgjedhjet, dhe ne atje nuk kemi asnjë pengesë ligjore, që të shpallim dhe të mbajmë zgjedhje edhe për këto dy komuna.

**Pyetje:**

**A është për ju inkurajues ky numër prej 21 subjekteve serbe që pritet të marrin pjesë në këto zgjedhje edhe për procesin e decentralizimit, ka pasur edhe kushtëzime, decentralizimi, pastaj zgjedhjet?**

**Përgjigje:**

Po, vlerësimet e mia janë se është edhe vet numri është inkurajues për interesimin e qytetarëve të komunitetit serb, të liderve të tyre që të marrin pjesë në jetën e tyre të përditshme shoqërore në shtetin e Kosovës që të pranojnë të drejtat që ju garanton kushtetuta dhe ligjet që të veprojnë mbi ato të drejta të faktorizohen tash sipas ligjeve ne fuqi, pra në nivelin lokal, të participojnë në nivelin qendror, dhe kjo edhe njëher dëshmon konstatimin se është një progres, se është në rritje numri i qytetarëve serb që janë të interesuar të bashkëpunojnë në Kosovë dhe që janë të interesuar që të krijojnë një perspektivë të përbashkët me të tjeret, pra me shqiptarët dhe komunitetet tjera jo shumicë. Por edhe në këtë rast do të theksoj se jo nëpër të gjitha lokalitetet me shumicë e

kemi situaten e njëjtë, kjo është edhe aryeja e vendimit tonë sidomos në veri do të kisha thënë edhe përkundër një interesimi të mirë të qytetarëve, ambienti është tejet i pasigurtë, ngase mungon edhe siguria e shprehjes së lirë, siguria e organizimit politik, mungon siguria që në mënyrë publike ata të bashkpusojnë me fqinjët e tyre të bashkpusojnë me institucionet e Republikës së Kosovës, me partnerët ndërkombëtar, prandaj edhe veprimi i Euleksit, edhe i policisë në aspektet e sigurisë por edhe veprimi i shoqërisë civile në aspektin e krijimit të një dialogu, që ka dhënë rezultatet e para në Mitrovicë, ku dëshmon se ekziston një dëshirë e qytetarëve që të bashkpusojnë dhe të ndërtojnë një kualitet të përbashkët, në Mitrovicë, pra edhe në lokalitetet e tjera, mendoj se do të jetë një prioritet për punët tona në të ardhmen. Kuptohet veprimet e Beogradit, sjellja e Beogradit në atë pjesë ka pasë një ndikim të fuqishëm dhe të gjitha ndihmat materiale i ka shndërru në një fuqi politike prandaj qdo ditë e më tepër po zvogëlohet ndikimi i Beogradit ngase i ka zvogëluar fondet, pagat, dhe se qytetarët e kanë pa se ajo formë e jetës ju ka mërzhitur, nëpër enklava po e thojne qdo ditë, por shpresojmë se edhe veriu i Kosovës do të bëhet një mes i sigurtë që qytetarët të shprehin ambiciet dhe interesin e tyre dhe jam i bindur se ata do të mirëpresin ofertat që do t'iu vijnë nga institucionet e Kosovës, konform ligjeve, kushtetutës së ligjëve të Kosovës që janë më të avancuar në regjion dha ata do të shohin se ajo çka tani po ndodh me ta është keqpërdorim i tyre, por njëkohësisht është edhe mungesë e perspektivës.

**Pyetje:**

**Pra mund të përmbledhim mesazhet që janë dërguar nga qeveria, ICO, janë shumë të qarta, se tash për tash problemet më të mëdha qëndrojmë me veriu e Mitrovicës, atje duhet të formohet komuna, a ka ndonjë afat të caktuar kohor, përmendët...?**

**Përgjigje:**

Ne kemi afate kohore, ligjet janë precize në këtë drejtim do të thotë, jo sipas Pakos së Ahtisarit, jo më vonë se 6 muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve, por brenda Pakos së Presidentit Ahtisari, është afati 3 vjeçar i implementimiti të plotë dhe analiza që duhet bërë procesit të decentralizimit, dhe nëse pra mund të bëhen këto përgatitje dhe krijohet besueshmëria, se edhe në Mitrovicë mund të implementohen ligjet e Republikës së Kosovës kjo mund të ndodhë jo më larg se 6 muaj pas zgjedhjeve, pra ne vet varemi nga mesi, dëshirat e qytetarëve, lidertë dhe bashkpusimi që do ta kemi për të parë se a mund ta implementojmë pra këtë pjesë të ligjit dhe të projektit tonë të reformës së pushtetit lokal në këto afate, afatet janë të sakta, por rrethanat janë ato që nganjëherë dijnë me prolongu, unë po shprehi dëshirën timë që të mos ketë nevojë me prolongu që të mos ketë nevojë me humbë kohën kur flitet për interesin e qytetarëve të Kosovës.

**Pyetje:**

**6 muaj pas zgjedhjeve lokale?**

**Përgjigje:**

Po, pikërisht vet qëllimi i fuqizimit të institucioneve lokale dhënja e më shumë kompetencave, krijimi i një autonomie ka për qëllim që qytetarët e Kosovës të marrin shërbimin e një institucioni të fuqishëm që të menagjojnë me ato të drejta dhe në këto raste qytetari nuk ka pse të improvizojë më tutje, nga që strukturat paralele, që qytetarit nuk i pëlqejnë dhe nuk i kanë përbush ambiciet e qytetarit, unë mendoj që kjo është forma më e mirë që strukturat paralele, të mos funksionojnë më tutje, sepse nuk është më në interesin e qytetarëve, pse qytari të kishte pasë nevojë të ketë në strukturën legale dhe legjitime kryetarin e komunës, qoftë sipas dëshirës së tyre dhe aty ku është me shumicë demokratike, është e pritshme që të jetë i komunitetit serb dhe një strukturë paralele, dhe unë mendoj se kjo është forma më e mirë. ..

Jo, ndoshta ne ditën e parë por shumë shpejt strukturat paralele do të shuhën. Në veri procesi do të jetë më i ngadalëshëm por edhe atje do të rritet do të fillojë që në këtë vit dhe dalangadalë do të rritet prezenca e institucioneve të Republikës së Kosovës, në forma të ndryshme, sikurse do të rritet edhe prezenca e evropiane nëpërmes Këshillit të Evropës dhe formave të ndryshme në

pjesën veriore të Kosovës, dhe kjo do të jete forma më e mirë që ne do të ofrohemi afër qytetarit, qytetari do të ketë lirinë, fillimisht që të bashkpunojë me institucionet dhe me faktorin ndërkombëtar në atë pjesë, dhe në atë pjesë, në kohën pak më të ngadaltë, por edhe atje nuk do të shihet më e nevojshme, por edhe nuk do të ketë struktura paralele për qytetarin, pra përgjigja ime është se me kohën fillimisht me pjesën tjetër të Kosovës dhe edhe në atë pjesë në veri strukturat paralele do të shkojnë duke u shuar.

**Pyetje:**

**Ndryshe komunat e reja do të kenë kompetencat e njëjta si komunat ekzistuese?**

**Përgjigje:**

Sipas ligjit për vetqeverisje lokale edhe këto tre komuna te reja që po formohen pra Graqanica, Ranillugu dhe Kllokoti që do të formohen do të kenë kompetenca të njëjta si komunat tjera, konform ligjeve të Republikës së Kosovës, me decentralizimin, simetrike janë disa kompetenca shtesë që ju jepen komunave me shumicë serbe si është trashëgimia kulturore, pastaj edhe emërtimi i komandantëve të stacioneve lokale, policore por njëkohësisht për Mitrovicën, Graqanicën dhe Shtërpcën është e paraparë, edhe disa kompetenca shtesë, me mjekësi sekondare me të drejtën që të themelojnë spitale, edhe Mitrovica në Veri që do të ketë të drejtën të themelojë të menaxhojë edhe Universitetin pra edhe një herë po e përsërisim, pra përgjigja është se edhe këto komuna janë komuna me kompetenca të plota konform ligjit me vetqeverisje lokale dhe ligjit për kufijë administrativ.

**Pyetje:**

**Ju jeni në kontakt, në teren me qytetarët serb, a ka ankesa që afati për formimin e komunave është i shkurtë?**

**Përgjigje:**

Nuk kemi pasë ankesa të tilla, kemi pasë përkundër në një pjesë një insistim që do të ketë, ngase në analizat tona gjatë gjithë muajve të fundit, sidomos dy javët e fundit kemi pasë dilema se në cilat komuna janë pjekë kushtet dhe në këtë fazë të analizës ata e kanë shfrytëzuar rastin që të thonë mendimin e tyre dhe të bëjnë një presion pozitiv dhe ta mbrojnë lokalitetin e tyre se aty janë krijuar kushtet që të mbahen zgjedhjet dhe se kanë dhënë baza të mira se qytetarët janë shumë të interesuar se do të dalin në zgjedhje dhe do të themelojnë strukturat komunale, ndërsa sa i përket vet aplikimit e vërteta është se ne jemi vonuar, na u ka deshtë më tepër kohë, analiza, konsultime me Presidencën, me Kryeministrin dhe me Shtetet e Kuintit, partnerët tjerë ndërkombëtar dhe pas një analize të tillë të një mirëkuptimi dhe të një mëbshtetjeje për të gjitha analizat që kemi bërë, pastaj krijimin e një grupi ndërministror, dhe kemi marrë vendimin për të cilin tash opinionin është i njoftuar. Ka mbetë e paqartë për një pjesë se KQZ, ka bërë përgatitje për 38 komuna, sepse ka qenë obligim sipas ligjit, dhe në këtë rast për opinionin, sidomos për partitë politike nuk ka qenë lajm themeilimi i 36 komunave, ppo lajm ka qenë se dy nuk po mund të themelohen, tani nuk ishte deshtë me pasë pasoja, unë po dëgjoj, kërkesa dhe opinione që çka të bëhet tash që partitë politike të kandidojnë sidomos nga komuniteti shqiptar, dhe anëtarë për asamamble komunale dhe kadiatët për kyetar në këto tri komunat e reja.

Mua më vjen shumë keq, nëse ata janë vonu, por ata është deshtë të jenë në kontakt, ngase i kanë përfaqësues në KQZ, dhe atje është dashtë me u ditë se po bëhen përgatitjet për 38 komuna. Ekziston një mundësi që aty ku ka ndonjë ngecje ndonjë gabim me plotësime KQZ, ka dhënë edhe tri afate për plotësimet e këtyre të njëjtave dhe kjo është ajo që kemi si informacion, përndryshe gjithë pjesa tjetër është kompetencë e KQZ.

**Pyetje:**

**Ju, në Minsitrinë e juaj, kujdes të veçantë i keni kushtuar informimit të popullatës, edhe asaj shumicë po edhe asaj serbe, rreth procesit të decentralizimit, por edhe fushata për sensibilizim?**

**Përgjigje:**

Patjetër, ka qenë më se e nevojshme, fillimisht ka qenë nevoja që qytetarët të informohen se çka ofron reforma e pushtetit lokal, cila është kompetenca që do të kalojnë nga niveli qendror në atë komunal, që ai do tu afrohet sa më afër qytetarëve, por ka qenë e domosdoshme edhe një dialog pak më i gjerë, ngase është kritikuar reforma e pushtetit lokal dhe decentralizimi, për një kohë shumë të gjatë dhe është krijuar një paragjykim se ai është një diçka e rrezikshme që po i ndodh Kosovës, e vertetë ajo i ka ndodh të gjitha shteteve të regjionit, vetëm Serbia është pak sa më mbrapa, dhe shihni ambientin në Maqedoni edhe përkundër se ka pasë 120 komuna tash 80 komuna, sot qytetari shqiptar në Maqedoni ndihet më mirë, edhe në Kosovë është e kundërta e asaj se nëse krijohet një komunë e re është rreziku i ndonjë keqprdorimi të atij pushteti dhe une është deshtë të komunikoj, të krijoj një fushatë që të sqarojmë se filozofia e Pakos së Ahtisarit dhe qëllimi i implementimit të ligjeve dhe krijimi i komunave të reja është pikërisht atakaimi i kësaj ideje, ne kemi akoma, për fat të keq ambientin jokomunikues, refuzues, Leposaviain, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Mitrovicën Veriore, në relacionet dhe obligimet që kanë me insititucionet e Republikës së Kosoëvës, pra njësinë e Admistrimit të Pushtetit Lokal, unë atë nuk e marr, se ai është një pretendim real për ndonjë ndarje, por është më tepër një rezistencë që të normalizohet jeta në atë pjesë dhe themelimi i komunës tjetër kudo, ajo është një mundësi që të integrohen komuniteti serb pastaj krijimi i kompetencave nëpër komuna është mundësi që komuna të fuqizohet dhe kemi zhvillu, kemi pasë shume kontakte, intersime sidomos me komunitetin serb, kemi bërë prodhimin e spotëve dhe emetimin, takimeve, dhe unë mendoj se ka qenë një situatë e vështirë e imja që fillimisht akoma një pjesë e opinionit dhe një pjesë e personave që kanë folë për decentralizimin janë sjellë sikur ne jemi në kohën e dizajnit dhe në kohën para vendimeve të Ahtisarit, dhe në kohën para shpalljes së Kosovës shtet i pavarur që në deklaratën kushtetuese eka marrë përsipër implementimin e Pakos së Presidentit Ahtisari, dhe kemi shpenzuar mbi 6 muaj, gati 1 vit deri sa kemi ardhë në situatën që të themi se kjo është e dobishme, është edhe kusht për pranimin e Kosovës në Bashkësi Ndërkombëtare dhe tani qytetari ka filluar ta kuptojë, se cili është interesi i tij..., gjelberimi, ambienti, uji dhe çështje tjetër, dhe kisha dëshirë që të ketë qeë ky interesim para një viti e gjysmë, të ishte procesi, ne kemi mujtë me më pak dilema, më të lehtë në implementimin dhe duke lënë përshtypje më të mirë edhe te bashkëqytetarët serb se ata mund të shfrytëzojnë të gjitha të drejtat që ju garanton kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës, në integrim në shoqëri duke dëshmuar një bashkjetese të përcaktuar me kushtetutë dhe me ligjet në mënyrë që ne sa më shpjet të krijojmë një shoqëri funksionale që i plotëson të gjitha standardet që kërkohen dhe do të kërkohen nga Kosova në afirmimin e saj, se kemi shume shtete që nuk na pranojnë dhe duke parë se si po sillemi me shtetin me të drejta dhe përveç pranimeve kemi edhe rrugëtimin tonë në integrimin euroatnatik dhe këto janë standarde të pashmangshme, por më gëzon fakti se edhe përkundër mungesës së një suksesi të plotë që vijnë nga sjellja e Beogradit, nga frikësimi, nga dilemat që kanë qytetarët serb, kemi marrë vlerësime pozitive edhe në raportin e Këshillit të Evropës edhe nga Grupi Ndërkombëtar i krizave, pra kemi marrë lavdata, për punën e madhe që po bëjmë, për kontaktet me gjithë qytetarët e Republikës, dhe mu më bën der, shtetit të Kosovës, dhe shpresojmë edhe në të ardhmen do të jepin vlerësime të tilla.

**Pyetje:**

**I përmendët bartjen e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, deri ku është arritur?**

**Përgjigje:**

Është një mori që parashikohet të kalojnë nga niveli qendror në atë lokal, dhe ne kemi filluar me shërbimin e përkujdesjes sociale, tani komunat janë kompetente për shërbimet sociale, të gjitha, edhe ndihmat sociale, edhe kategoritë e veqanta, komuna është, qytetari nuk ka nevojë më që të vijë dhe të humb kohë nëpër zyrat e e Ministrisë përkatëse, por tani këto shërbime i ka në komunë e vet, po ashtu gjithëqka është definuar dhe tani komuna ose komunat, varësisht, nëse një ndërmarrje ofron shërbim për një komunë apo tri komuna, aty ku është më tepër se tri komuna, puna udhëhiqet në borde, aty ku është një komunë do të thotë vet komuna udhëheqë me këto ndërmarrje, të ujit, fabrikat e prodhimit të ujit, pastaj grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave, pra pastërtia e qytetit tani është kompetencë e plotë e komunës dhe gjithë ndërmarrja edhe asetet, edhe pasuritë, edhe kapacitetet njerëzore, edhe pasuria, edhe pajisjet, gjithëqka ju ka dorëzuar komunës për drejtim, jemi duke bërë përpjekje që pos rregullave në

trafikun urban që komunave t'ia bartim edhe kapacitetet, pra pasuritë e njësive të stacionit të autobusëve, që kemi shumë problem me prona atje , qështja e licencave për biznesin, pastaj qështjet e disa pronave, siq janë kullosat dhe disa të tjera që janë të rëndësishme për komunën, pra të gjitha këto kompetenca dhe një sërë kompetencash që lidhen me administrim më të fuqishëm me shërbimet në raport me qytetarët, dhe deri në fund të këtij viti do të përfundojë gjithqka , në aspektin e bartjes së kompetencave në përjashtim të pronave që kemi shumë punë me Agjencionin Kosovar për Privatizim dhe ajo mendoj të mos jete vetëm detyrë e Ministrisë, por edhe e Qeverisë edhe e Parlamentit, edhe e Agjencionit Kosovar për Privatizim që të merret me këtë.

Pra me delegimin e këtyre kompetencave dhe konform ligjit për vetqeverisje lokale një autonomi e fuqishme që i krijohet tani komunës që do të jetë plotësisht e pavaruar në ushtrimin e këtyre përgjegjësive si dhe përdorimit të të gjitha mjeteve që ajo inkason, pra mjete që i shkojnë nga granti qeverisës dhe një mbështetje të fuqishme financiare që i ofrojnë komunave – pra kjo komunën e Kosovës e bën komunën më të fuqishme në regjion, dhe në aspektin e të drejtave, dhe në aspektin e mundësive që ajo tani ka me zhvillu dhe me sjellë në shërbim të qytetarit. MAPL e ruan të drejtën e vet sipas ligjit të monitorojë zbatimin e ligjit, por ka mundësi që aty ku shkelet kushtetuta dhe ligjet, që ne t'i sugjerojmë kryeministrit, gjegjësisht kabinetit qeveritar që të marr veprime dhe që pastaj me këtë qështje t'i drejtohet gjykatës, prapë mund të bëj veprime të njëanshme, sipas ligjit nuk parashikon shkarkimin e kryetarit nga strukturat politico-administrative por vetëm nga gjykata aty ku shkelet kjo, dhe niveli i shërbimeve që duhet të përcaktojë se sa është niveli i shërbimeve që i ofrojnë qytetarit në mënyrë që ne pastaj të koordinojmë edhe me donatorët të mbështetemi edhe nga partnerët ndërkombëtar dhe t'i dalim në ndihma komunave në forma të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve që ata kanë nevojë ta bëjnë.

#### **Pyetje:**

**Çka përfitohet me këtë proces, cili është synimi?**

#### **Përgjigje:**

Synimi është që sa më shumë kompetenca të shkojnë në komunë në mënyrë që e gjithë jeta e qytetarit të zhvillohet në komunë, të gjitha shërbimet qytetari t'i merr në komunë, duke ruajtur vetëm atë pjesën e interesit nacional, dhe përfaqësimit të shtetit, siq është Ministria e Punëve të Jashtme, si është dogana, si është politika nacionale, në infrastrukture, në ambient, ndotje etj, dmth sikur qdo shtet tjetër, që ka vetëm qështjet nacionale dhe të gjitha shërbimet që lidhen me përditshmërinë e qytetarit do të shkojnë në komuna, pra kjo mendoj që është qëllimi kryesor, produkti kryesor dhe unë mendoj që në këtë concept dhe me respektim të ligjit në kemi shënuar një progres, unë mendoj shumë të mire, dhe t'iu përkujtoj me këtë rast se edhe vendet me një qeverisje më stabile, me një traditë të qeverisjes që kanë procesin e reformës së pushtetit lokal decentralizimin, përveq se fillimisht ju ka marrë shumë më shumë vite se që po na merr neve deri tani , pra gjithmonë është një proces konstant, një process i vazhdueshëm , edhe sot ti e ke aktual decentralizimin në Gjerman, në Francë, në Angli dhe vende të tjera, sepse gjithmonë ka vende që duke u pjekë shoqëria, duke u fuqizuar institucionet lokale, shteti e krijon besimin se ajo kompetencë mund të menaxhohet dhe mund të shtrohet në një komunë dhe pastaj vazhdon ta dedikojë kah komuna, dhe në këtë, unë mendoj se kemi arritë një sukses të shkëlqyeshëm, ngase për një vit e gjysëm, jo tri vite sa parashikon Pakoja e Ahtisarit, por vetëm për një vit e gjysmë, vlerësimt e mija diku 70, 75 % të punës e kemi përfundu, në një shoqëri me shume probleme, në një shoqëri që pas luftës është me shumë pasoja, në një shoqëri që akoma ka humbje të besimit, akoma ka interferime nga shtete fqinje dhe ata me qëllime më të kqija dhe të cilët veprojnë siidomos në veriun e Kosovës, dhe deri tani e lavdrojën punën tonë,. Një gjë të themi se edhe ata që nuk e shikojnë me sy të mirë punën tonë nuk kanë mundur me kriju asnjëherë një argument që ta kritikojnë qasjen e institucioneve të Republikës së Kosovës, ka mbetur shumëqka për të bërë ka shumë sfida, veriu i Kosovës është një sfidë e veçantë, ngase atje duhet të fillojë që të sigurohet një prezencë e institucioneve të Kosovës, duke filluar nga një presence, duke fillu nga një dialog me qytetarët deri në një administrim dhe deri në krijimin e kushteve që edhe atje të normalizohet jeta dhe që edhe atje qytetari ta sheh se Republika e Kosovës është shtet i të gjithë qytetarëve të saj, se ai ndodhet në shtetin e vet dhe të largohet nga perceptimi se Kosova është shndrru në një shtet të dikujt , të shqiptarëve dhe se qka po ndodh me serbët, dhe se serbët janë qytetarë të

barabartë në Republikën e Kosovës dhe se edhe në Ballkan mund të përsëritet jeta e një Zvicre dhe jeta e shumë shembujve të tjerë që ka njerëzimi dhe që kanë ditë popuj të ndryshëm me ndërtu të njejtin shtet, m'u ndi të barabartë dhe me pasë jetë kualitative.

**Fund**